

Degustimi

Në Tiranë zhvillohen shpesh gjithëfarëloj aktivitetesh por një mbrëmje degustimi vere nuk është një nga ato ndodhi që meriton dritën e prozhektorëve. Por rastësisht në një ambient vërtet të jashtëzakonshëm si “Hotel Dinastia” në një nga ato mbrëmjet fantastike të marsit pa shi ishte prezent ai që njihet në botë si gjeniu slloven i verës. Ales Kristancic ishte në Tiranë në shoqërinë e bashkëpunëtorit të tij Demo Haliti. Duket si një nga ato romane ku kufijtë e shteteve kalohen si pa të keq por ja ku ishim. Dhjetëra të ftuar mes atyre që njihen si konsumatorët më të mirë të verës në Tiranë, ne të “Jetës”, Demo një shqiptar babaxhan nga Maqedonia dhe ai që pa frikë mund të quhet Michael Jackson i verës nga Sllovenia.



Ales rrëfen histori të pabesueshme. Janë histori toke, kontakti me natyrën, histori familjare dhe krejt pa prituri harron që kryefjala është vera por kthehet në një mbrëmje poetike ku avujt e pijes më të dashur në botë kthehen në sfond.

Demo Haliti është njeriu i verërave sllovene në Shqipëri dhe sot ka sjellë Movia, një nga prodhuesit prezent në Top Ten-in botëror. Nuk e kupton mirë përse Demo ndodhet pas këtij demonstrimi, i them që fare mirë mund të fusë tonelata verë qoftë edhe cilësore pa shpenzuar asnjë qindarkë në këto lloj aktivitete por për të kënaqësia nuk është vetëm tek fitimi. Pasioni i tij lidhet mbi të gjitha me llojin e verërave që sjell dhe me faktin që ato duhet të jenë absolutisht eko. Bio. Pa kimikate të shtuara. Dhe këtu Demo bëhet serioz dhe i ikën ajo buzëqeshja e mbrëmjes. Thotë se ka konstatuar nga udhëtimet e tij nëpër botë se ne kemi ushqimet më të shijshme dhe cilësore ndaj nuk e kupton pse shoqërimi nuk duhet të jetë i tillë. Por ky nuk është destinacioni i vetëm i shqiptarëve të Maqedonisë. Pasi të ketë arritur pozicionin që do në tregun tonë, hapi tjetër është pushtimi i botës me produkte shqiptare. Nuk do të ndodhë brënda natës, por pse të mos jenë produktet tona më të mira në tryezat anembanë botës fundja...

Dhe gjithçka sipas tij është në punë e sipër. Projekti i tij i njohjes së të shteteve të tjera me verërat shqiptare po ecën sipas parashikimeve dhe shumë shpejt këto mbrëmje degustimi që ai ka 5 vjet që i organizon nëpër Shqipëri do të fillojë t'i realizojë nëpër Europë.

Të nesërmen në mëngjes kemi caktuar takim me Ales. Spektakli që dhuron e konsumon shumë shpirtërisht dhe fizikisht. Një natë më parë gjatë fjalës u prek dhe lotët u përizen me verë. Audiencia reagoi njësoj, pasi është edhe ai që e ndjek audiencën jo



vetëm e kundërta. Sapo kthehet nga vrap dhe menjëherë thotë që është hera e tretë që vjen në Shqipëri dhe i pëlqen të bëjë vrap rreth Liqenit Artificial kaq pranë Hotel Dinastisë.

Flasim pashmangshmërisht për verën edhe pse është orar kafeje. Për Kristancin që këmbëngul t'i drejtohes me ti, vera është si jeta e vërtetë dhe të shenjon gjithë jetën. Këmbëngul tek rëndësia jetike e asaj që fusim në trup. Edhe kafja thotë që nëse nuk i shijon e hedh tutje. Vreshtat e

tij të pamata shtrihen përgjatë kufirit italo slloven dhe përgjatë viteve të cuditshme të Luftës së Ftohtë pjesa më e madhe e tokës së tij shtrihej në Italinë e largët për Jugosllavinë megjithëse një vijë imagjinare ishte ajo që bënte ndarjen.

Familja është një temë shumë prezente në bisedën me të. Toka, familja, dashuria me të cilën flet edhe për një copë djathë të shijshëm të bërë nga duart e një fshatari që ushqen fëmijët me të, të le pa mend.

Një burrë interesant që për filozof nuk ka askënd nga klasikët e mëdhenj e as nga radikalët e rinj por fshatarët e thjeshtë e të vërtetë që me punën e tyre të palodhur bëjnë vërtetë që jeta të vazhdojë.

Sipas tij e ardhmja do të jetë e kundërta e revolucionit industrial dhe të gjithë do të hapim sytë e do të kuptojmë rëndësinë e atyre produkteve biologjike, e atyre hapësirave të gjelbra që i përdorim vetëm për ndonjë fundjavë të rrallë.

Kur e pyes për spektaklin që vuri në skenë një natë më parë i ndryshon cehra. Nuk është më ai burri i madh dhe i sigurt në vetvete. Më thotë se i thonë shpesh që bën shiow "por unë nuk di të bëj show, thjesht tregoj ato që di për verën, për ushqimin dhe për jetën".

Me tregon që pas 8 brezave në biznesin e prodhimit të verave akoma nuk e di se si shitet kjo pije me litra, por ai punon me fansat e produkteve të tij, me dashamirësit e asaj

pije për të cilën ai punon çdo ditë.

Verërat Movia shumë i quajnë vera elitare, fundja është një ndër 10 markat më të mira në botë por Ales këmbëngul që është e kundërta. "Janë verëra toke jo fabrike - më thotë – ndaj kam nxjerrë një shishe shumë më të madhe, që si mbretërit ashtu edhe të përvuajturit, të pijnë nga e njëjta shishe e mjaftueshme për të gjithë, sepse edhe Toka jonë kështu është, ka vend për të gjithë."